



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:275537
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05730393

K.DH.SH.II.nr.447/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Franciska Zhitija Ymeri kryetare e kolegjit, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “ASHA” Shpk me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Agron Selimaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.103/23 të datës 11.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 24.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditurës Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve me seli në Prishtinë, e datës 04.01.2024, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.103/23 të datës 11.12.2023, **vërtetohet.**

A r s y e t i m

Me aktvendim e Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.103/23 të datës 11.12.2023, ka vendos dhe atë; në pikën I të dispozitivit, Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “ASHA” Shpk, kundër të paditurit Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve. Në pikën II, ndryshohet vendimi nr.12/2023 i datës 09.02.2023 i nxjerrë nga i padituri Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, ashtu që të aprovohet ankesa me numër protokollit 45/2023 e datës 10.01.2023 e ushtruar nga Shtëpia

Filmike “ASHA” Shpk dhe anulohet vendimi nr. 01/2023 i datës 05.01.2023 i nxjerrë nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Nën pikën III. Mbetet në fuqi vendimi KD.nr.51/2022 i datës 30.12.2022 i nxjerrë nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Nën pikën IV. Ky aktgjykim i zëvendëson aktet e anuluar dhe ka karakter detyrues. Nën pikën V. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura, përmes përfaqësues së autorizuar Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që aktgjykimin e goditur me ankesë ta ndryshoj dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 49 par.1 të LKA-së, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me vendimin i ankimuar të paditurës me nr.12/2023 të datës 09.02.2023, nën pikën I. të dispozitivit, është refuzuar si e pa bazuar ankesa me numër protokollit 45/2023 e datës 10.01.2023 e parashtruar nga Shtëpia filmike “ASHA” Shpk, nën pikën II. Mbetet në fuqi vendimi nr.01/2023 i datës 05.01.2023, numër të protokollit 13/2023. Nën pikën III. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga anëtarët e Komisionit.

Kundër Vendimit të paditurit, paditësi inicion konflikt administrativ, me padi i drejtohet gjykatës Dhoma e Shkallës së Parë, në këtë çështje juridike administrative, me datë 04.12.2023, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të përfaqësuesit të paditësit e në mungesë të përfaqësueses së paditurës dhe pas administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, duke ndryshuar vendimin nr.12/2023 të datës 09.02.2023 i nxjerrë nga i padituri Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve, dhe anulohet vendimi nr. 01/2023 i datës 05.01.2023 i nxjerrë nga Qendra Kinematografike e Kosovës, sipas konkludimeve në arsyetim se; gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i

padituri nuk ka vepruar drejtë kur ka shtuar kriterin shtesë “7. Regjisorët të cilët nuk e kanë përfunduar fazën e xhirimit të filmit të përkrahur më parë nga QKK, nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në cilësinë e regjisorit” në konkursin për film të metrazhit të gjatë-artistik (mbi 60min) ref.nr. QKK 01/2022. Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues gjykata iu referua nenit 33 dhe 36 të Ligjit nr.2004/22 për kinematografinë, po ashtu gjykata iu referua nenit 13 të Rregullores (MKRS)-nr.07/2016 për subvencionimin e Projekteve Filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës, i cili përcakton kufizimet e pjesëmarrjes në konkurs. Gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i padituri duhet të shtrihet në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat janë rregulluar me akt juridik, në rastin konkret kriteret janë përcaktuar në mënyrë taksative me rregulloren për Subvencionimin e Projekteve Filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës. Gjykata vendosi që të anuloi si të kundërligjshëm vendimin nr.12/2023 të datës 09.02.2023 dhe vendimin nr.01/2023 të datës 05.01.2023 i nxjerrë nga i padituri Ministria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe mbetet në fuqi vendimi KD.nr.51/2022 i datës 30.12.2022 në kuptim të nenit 43 të LKA-së. Andaj gjykata duke pasur parasysh edhe urgjencën në trajtimin e ligjshmërisë së akteve kontestuese, meqë paditësi ka qenë përfitues i subvencionit gjatë vitit 2023 dhe se në vitin 2024 i padituri do të hap konkursin e ri për subvencionim konform nenit 36 të Ligjit për Kinematografinë, gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e akteve të goditura me padi në mënyrë meritore dhe vendosi vet për çështjen, pasi që të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës kanë dhënë bazë të sigurt për vendosjen e çështjes administrative nga gjykata. Andaj bazuar në nenet 13 par.1 nën par 1.12 lidhur me par.5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Dhoma e Shkallës së Dytë duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin juridik të Dhoma e Shkallës së Parë dhe konstaton se drejtë ka zbatuar dispozitat ligjore të LKA, dhe LPA-së, kur ka vendosur për të aprovoj padinë e paditësit në kuptim të nenit 43, 44 dhe 46 par.4 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Njëjtë si Dhoma e Shkallës së Parë edhe kolegji, vlerëson se Vendimi e i të paditurit, është nxjerrë në kundërshtim me nenin 33 të Ligjit nr.2004/22 për Kinematografinë, ku qartë përcaktohet se: “1.Në përputhje me programin e aktiviteteve dhe potencialin financiar për vitin përkatës, jo më larg se dy muaj pas miratimit të mjeteve buxhetore, këshilli drejtues shpall konkurs për projekte filmike: për filma artistikë të metrazhit të plotë e të shkurtër, për filma dokumentarë dhe për filma vizatimorë të animuar 2.Të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs kanë të

gjithë personat juridikë, vendës ose të huaj të regjistruar në Kosovë si subjekt biznesi për prodhimin e filmit (producentët filmik), si dhe kineastët me statusin e artistit të lirë, nëse me këtë ligj nuk përcaktohet ndryshe. Nuk kanë të drejtë pjesëmarrjeje në konkurs punëtorët e QKK dhe anëtarët e Këshillit drejtues 3.Procedurat e përzgjedhjes së projekteve rekomandohen nga këshilli drejtues, kurse miratohen nga ana e Ministrit”. Po ashtu neni 36 parasheh: “Këshilli Drejtues, me propozim të drejtorit të QKK, çdo vit shpall konkurs për film artistik të metrazhit të shkurtë, për film dokumentar dhe për film vizatimor - të animuar, me të drejtë pjesëmarrjeje vetëm për kineastët e rinj që sapo kanë përfunduar arsimin univerzitar profesional”. Ndërsa neni 37 parasheh: “Këshilli Drejtues miraton dhe subvencionon projekte filmike (duke përcaktuar edhe kuotën e subvencionit) në bazë të përzgjedhjes nga juria vlerësuese dhe raportit të komisionit financiar”. Andaj Kolegji, ka vlerësuar se i padituri ka vepruar në mënyrë të kundërligjshme kriterin kufizues dhe në këtë rast paditësit i janë cenuar të drejtat, pasi që një kriter i tillë nuk është i përcaktuar në Ligjin për Kinematografinë dhe as me Rregulloren për Subvencionimin e Projekteve Filmike nga Qendra Kinematografike e Kosovës.

Pretendimet ankimore të paditurës se gjykata me rastin e marrjes së aktgjykimit nuk i ka vlerësuar drejtë provat e paraqitura nga ana e të paditurës, arsyetimin e aktgjykimit e bazon thjeshtë në prova dhe të dhënat të cilat i arsyeton paditësi, po ashtu sa i përket vlerësimit të gjendjes faktike gjykata nuk u bazua në faktet e dhëna nga e paditura në këtë rast gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë me rastin e vendosjes së kësaj lënde, kolegji i refuzon si të pa bazuara, jo të qëndrueshme dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes. E paditura në rastin konkret nuk ka paraqitur asnjë provë konkrete me të cilën do të mund të konstatonte një gjendje tjetër faktike nga gjendja e konstatuar nga Dhoma e Shkallës së Parë, pasi Dhoma e Shkallës së Parë në bazë të provave të administruara në seancën kryesore, si dhe shkresave të tjera ka nxjerrë prova të mjaftueshme dhe në mënyrë të plotë dhe të drejtë e ka vërtetuar gjendja faktike, me rastin e aprovimit të kërkesë padisë së paditësit, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, bazuar në faktet e paraqitura si në arsyetim të aktgjykimit të mbështetura në dispozitat ligjore. Andaj, sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, aktgjykimi i ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, ngase nuk është shkelur ligji material në dëm të paditurës.

Numri i lëndës: 2023:275537
Datë: 24.05.2024
Numri i dokumentit: 05730393

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shklës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.447/24, me datë 24.05.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri